

**Akt i themelimit  
te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar  
" A.M.U "Ndertim-Montim  
Sh.p.k.**

Sot me date 5.10.2001, para meje Noterit Arian Merkuri anetar i Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht Z.Roland Veseli, i biri i Mehmetit, i datlindjes 03.03.1969, lindur e banues ne lagjen "Kastriot", Pallati Nr.5, Shkalla 1, Ap.7, ne Fush-Kruje, per identifikimin e te cilit u bazova ne dokumentin e identifikimit Pasaport Nr 0187014, ne cilesine e ortakut te vetem te Shoqerise "A.M.U" Ndertim-Montim Sh.p.k, person madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar. Ai me vullnetin e tij te plote dhe te lire nenshkruan para meje kete Akt-Themelimi :

**I  
Krijimi**

Ortaku i Vetem Z.Roland Veseli krijon Shoqerine me Pergjegjesite Kufizuar "A.M.U" Ndertim-Montim Sh.p.k., sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise.

**II  
Selia**

Selia e shoqerise "A.M.U" Ndertim-Montim Sh.p.k ndodhet ne adresen : Lagje "Kasterjot", Pallati Nr.5, Shk Nr.1, ApNr.7 Fush-Kruje. Shoqera mund te hape filjale dege perfaqesimi ne qytete te tjera te Republikes se Shqiperise.

**III  
Objekti**


Shoqeria ka per objekt te veprimtaris se saj: Punimet me hekur dhe duralumin te llojeve e permasave te ndryshme, promovimin dhe shitjen e tyre me shumice e pakic

Projektimin dhe istalimin e konstruksjineve metalike, mirembajtjen dhe konsulencen ndaj tyre

Projektme dhe ndertime hidraulike dhe konsulencen ndaj tyre.

Ndertime godina civile

Shitblerjen e artikujve industrial, te cdo lloji, te vendit dhe te importit, shitblerje te konfeksioneve te ndryshme, shitblerjen e artikujve te materjaleve te ndertimit, te cdo lloji si te vendit dhe te importit, si dhe cdo



veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë e që nuk bie ndesh me legjislativonin në fuqi.

**IV**

**Organet e shoqërisë**

Organet e shoqërisë "A.M.U" Ndertim-Montim Sh.p.k janë :

- Ortaku i vetëm i shoqërisë .
- Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe të funksionimit do të përcaktohen në statusin e shoqërisë .

**V**

**Përgjegjësia personale**

Prona private e ortakut të vetëm të shoqërisë jashtë kufijve të kuotave që ai zoteron në kapitalin e shoqërisë, drejtuesit, administratorët, punëmarresit ose përfaqësuesit e shoqërisë janë gjithmonë të përjashtuar nga detyrimet e çdo lloji që rëndojnë mbi shoqërinë.

**VI**

**Afatet e aktivitetit**

Shoqëria "A.M.U" Ndertim-Montim Sh.p.k do të fillojë aktivitetin e saj duke depozituar të paktën 100.000 (njëqind mijë) lek në të holla si kapital themelues i shoqërisë, i cili do të formohet tërësisht nga ortakut i vetëm. Ortaku i vetëm nuk kufizohet në rritjen e kapitalit të shoqërisë. Shoqëria do të ketë kohegjatje deri në 25 vjet, ajo mund të shpërbehet në çdo kohë me vendim të ortakut të vetëm themelues të saj.

**VII**

**Norma të organizimit**

Normat për organizimin, rregullat dhe drejtimin e administrimit të aktivitetit të shoqërisë "A.M.U" Ndertim-Montim Sh.p.k dhe çështjeve të saj të brendshme janë parashikuar në statutin bashkëngjitur, i cili mund të modifikohet në çdo moment me vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë. Shoqëria do të ketë vullnet dhe ku janë përcaktuar inicijalët dhe emertimet e saj

Fushe - Krujë, më 5.10.2001.

**THEMELUESI**  
**Roland VESELI**





**Statuti**  
**i**  
**Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**“ A.M.U ” SH.P.K**  
**Ndërtim-Montim**

**I. Emri**

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “A.M.U” Ndërtim-Montim sh.p.k.

**II.Ortaku i vetëm i shoqërisë**

Ortak i vetëm i shoqërisë “A.M.U” Ndërtim-Montim Sh.p.k është Z. Roland Veseli i biri i Mehmetit, lindur dhe banues në Fush-Krujë.

**III. Kapitali i shoqërisë**

Kapitali themelues i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lek dhe është i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1.000 (njemijë) lek secila. Kapitali i shoqërisë nënkruhet dhe derdhet tërësisht në të holla nga Ortaku i vetëm i shoqërisë, ku Z.Roland Veseli zotëron 100 kuota.

Kuotat e kapitalit janë plotësisht të transferueshme në çdo moment sipas ligjit shqiptar në fuqi.

Përgjegjësia e ortakut të vetëm për detyrimet e shoqërisë kundër të tretëve shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e shoqërisë.

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të administrohet nga ortaku i vetëm. Një pjesë e këtij fitimi mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit të shoqërisë. Shoqëria është e detyruar të shlyej të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit dhe të tretëve.


**IV.Selia e shoqërisë**

Shoqëria “A.M.U” Ndërtim-Montim Sh.p.k është e regjistruar në Lagjen “Kastriot” Pallat Nr.5, Shkalla Nr.1, Ap Nr.7, qyteti Fush-Krujë.

Ajo mund të krijojë degë, filjale, agjensi, përfaqësi si dhe t'i suprimojë ato kur është e arsyeshme.

**V. Objekti**

Shoqëria “A.M.U” Ndërtim-Montim Sh.p.k ka për objekt :



Punimet me hekur dhe duralumin te llojeve e permasave te ndryshme, promovimin dhe shitjen e tyre me shumice e pakic  
Projektimin dhe instalimin e konstruksjoneve metalike, mirembajtjen dhe konsulencen ndaj tyre.

-Projektme dhe ndertime hidroteknike dhe konsulenca ndaj tyre.

-Ndertime godina civile.

- Shitblerjen e artikujve industrial, te çdo lloji, te vendit dhe te importit, shitblerje te konfeksioneve te ndryshme, shitblerjen e artikujve te materjaleve te ndertimit dhe atyre hidraulike e hidrosanitare, te çdo lloji si te vendit dhe te importit, si dhe çdo eprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin ne fuqi.

- Shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera qe kane objekt te ngjashem me te

- Per kryerjen e veprimtarise se saj shoqeria do te hape njesi prodhuese, grumbulluese, perpunuese, sherbimi e tregëtimi, duke bashkepunuar me persona fizik e juridik vendas dhe te huaj .

## **VI. Kohezgjatja**

Shoqeria "A.M.U " Ndertim-Montim Sh.p.k do te zhvilloje veprimtarise se saj per nje periudhe 25 vjecare dhe mund te shperbehet ne çdo kohe e per çdo lloj shkak


## **VI.Vendimi i ortakut te vetem**

Organ vendimor jane vendimet e ortakut te vetem Z.Roland Veseli i cili mund te marre çdo lloj vendimi pa asnje kufizim me perjashtim te atyre qe do te jene kompetence e administratorit.

Ortaku i vetem i shoqerise merr vendime per ndryshimin e ketij statusi, shperndarjen e shoqerise, kooperimin ne cdo lloj forme me shoqerite e tjera, shtimin ose pakesimin e kapitalit te shoqerise ose te kuotave te tij, transferimin e nje pjese apo te gjithe kuotave te kapitalit te shoqerise, emerimin ose shkarkimin e administratorit, aprovimin e raporteve financiare dhe bilancit brenda gjashte muajve nga perfundimi i vitit financiar te shoqerise, blierien dhe shitjen e pasurive te paluajtshme, ndryshimi i vendqendrimit te selise etj.

Ortaku i vetem ka te gjitha kompetencat per te kryer cdo veprim financiar dhe ka te drejte gjithashtu t`u dergoje me prokure personave te trete te zgjedhur prej tij,nje pjese apo te gjitha keto kompeteca.

## **VII.Administrimi**

 Shoqeria "A.M.U" Ndertim-Montim Sh.p.k mund te administrohet prej nje administratori te emeruar nga ortaku i vetem, per nje periudhe 3 vjecare, me mandat te rinovueshem. Ortaku i vetem gezon te drejten qe ne çdo kohe te shkarkoje nga detyra administratorin dhe te emeroje nje tjetër ne vend te tij.

Administratori ka te drejtu t'u delegeje me prokure permes miratimit paraprak nga ortaku i vetem, nje pjese apo te gjitha kompetencat qe i jane ngarkuar sipas statutit dhe qe njihen nga legjislacioni shqiptar per shoqerite tregetare

Administratori do te pergjigjet per administrimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise, dhe do t'a realizoje ate duke kryer te gjitha veprimet qe ai i konsideron te nevojshme per realizimin e objektivit te shoqerise, me perjashtim te atyre qe ligji ja ka rezervuar Ortakut te Vetem te Shoqerise.

Administratori do te pergjigjet penalisht perballe shoqerise ose te tretteve per shkelje te ligjit dhe/ose te statutit.

Ne rrast te shkeljeve te ligjit administratoro mund te shkarkohet ne çdo rrast me vendim te autoritrit gjyqesor .

### **IX. Viti financiar**

Viti financiar i shoqerise "A.M.U" Ndertim-Montim Sh.p.k fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregetar Shqiptar.

### **X. Ekspertet kontabel**

Ortaku i Vetem i Shoqerise do te emeroje nje apo me shume Ekspert Kontabel ne ato raste kur emerimi behet i nevojshem ne baze te ligjit shqiptar.

### **XI. Mardheniet e punesimit dhe lidhja e kontratave**

Mardheniet e punesimit brenda shoqerise regullohen nepermjet kontrates se punesimit, qe lidhet midis paleve ne perputhje me ligjin Nr.7961 date 12.07.1995 "Kodi i Punes", si dhe legjislacioni tjetër shqiptar qe ben fjale per punesimin.

Shoqeria mund te lidhe kontrata me sektore shteteror si dhe me persona fizik e juridik privat vendas dhe te huaj.

Ne veprimet kontraktuale shoqeria do te perfaqesohet nga Ortaku i Vetem Z.Roland Veseli ,ose nga nje person tjetër i autorizuar prej tij me prokure. Te drejttat dhe detyrimet qe lindin nga nenshkrimi i kontrates jane te detyrueshme per shoqerine.



**XII. Dispozita te fundit**

Cështje te tjera qe nuk jane trajtuar ne kete statut i referohen ligjit Nr.7638 date 19.11.1992,ligjit Nr.7667 ,date 28.01.1993,si dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi e akteve te tjere nenligjore te dala ne zbatim te tyre.

Te gjitha mosmareveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise kur ato nuk mund te zgjidhen me mirkuptim,do te kalojne ne kopetence te Gjykatesse Rrethit Tirane.

Tirane me 5.10. 2001.

**ORTAKU I VETEM**  
*Rdon8 Ueseh*